

PRANUAR MË:  
ACCEPTED ON: 27/09/2022  
PRIMLJENO:  
Nr.No.Br. 02/434



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/\_\_\_\_\_

Datë: 27.09.2022

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së pestë ( V ) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës

**RENDI DITËS**

- 1.Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Qershor 2022.
- 2.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës Nr.11/1298 datë: 22.06.2022 të Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, për miratimin e propozimit për ndryshimin e thirrjes, Shkolla e Mesme Profesionale “Lasgush Poradeci” në Kijevë, në institucionin e Arsimit dhe Aftësimit Profesional – IAAP “Lasgush Poradeci” në Kijevë.
- 3.Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Malishevës, për vitin 2021.
- 4.Shqyrtimi i kërkesës Nr.08/176 datë: 27.06.2022 të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 02/211 datë: 05.05.2022, për themelimin e vëndgjuetisë në Komunën e Malishevës.
- 5.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës të Komitetit për familje të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve të luftës së UQK-së, si dhe të Martirëve të luftës në Komunën e Malishevës.
6. Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve, për K.R.M Ekoregjioni, Njësia në Malishevë.

7.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës Nr.02/321 datë: 07.07.2022 të parashtruar nga Zj.Minire Helshani nga fshati Banjë, për ndihmë financiare për shërim.

8.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës Nr.02/341 datë: 27.07.2022 të parashtruar nga z.Pajtim F. Krasniqi nga fshati Tërpezë, për ndihmë financiare për shërim.

9.Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 09.08.2022 dhe filloi në ora: 09:30. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 21 asambleistë, drejtorë komunal,përfaqësues nga OSBE-ja dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës z.Argjend Thaçi.

**Argjend Thaçi:** Përshëndetje për të gjithë antarët e Kuvendit!

I nderuar nënkryetar,drejtorë komunal, përfaqësues të OSBE-së dhe gjithë ju të pranishëm!  
Në këtë mbledhje mungojnë Nebih Bibaj, Agnesë Kastrati, dhe Zamire Morina dhe 21 antarë janë të pranishëm në Kuvend.

A e do dikush fjalë jashtë rendit të ditës?

Burim Paqarizi e ka kërkuar fjalën.

**Burim Paqarizi:** Përshëndetje për të gjithë!

Dua të shprehi një shqetësim të banorëve të fshatit Dragobil dhe të fshatrave të tjerë, që kanë mungesë të funksionimit të mirë të ndriqimit publik. Ju lus që sa më shpejt të merrni masa. Po ashtu të bëhet dhe një rreth rrotullim në fshatin Dragobil dhe në fshatin Lubizhdë, për arsye se lidhja me rrugën është një rrezik shumë i madh dhe të merret kjo kërkesë parasysh sa më shpejtë.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit Burim, Alban Kastrati e ka kërkuar fjalën.

**Alban Kastrati:** Përshëndetje për të gjithë!

Ditëve të fundit janë bërë dy ndryshime të drejtorëve. Thuhet se ka dhënë dorëheqje për arsyet e tij personale Drejtori i Bujqësisë Murat Hoxha, ndërsa është shkarkuar Drejtoresha e Inspektoriatit. Jemi të preokupuar pak se për çfarë arsye është shkarkuar Drejtoresha. Ka bërë ndonjë shkelje ligjore apo çfarë?

Pyetjen e dytë e kam për Drejtorin e Administratës. Në qershor na ka premtuar që do të na pajisni me lloptop, kurse tani jemi në gusht dhe ende jemi pa lloptop.

**Argjend Thaçi:** Veton Zogaj e ka kërkuar fjalën, pastaj Labinot Gashi!

**Veton Zogaj:** Faleminderit, Kryesues!

Përshëndetje për të gjithë!

Ne vazhdimisht po ngrisim qështje, por asnjëherë nuk po realizohen ato. Kam një vërejtje për ju Kryesues, për neglizhencen për mos thirrjen e seancës në korrik. Arsyeja pse mungojnë disa asambleistë, është sepse gushti ka qenë pushim dhe nuk e di a e keni realizu vetëm 10% të atij plani.

Unë do i ngris 4 qështje këtu. E para ka të bëjë me mungesën e ujit të pijës në shumicën e fshatrave Drenoc, Bubavec, Kijevë, Mleqan deri në Bubël e Damanek.

Një ankes tjetër e kam për Drejtorin e Administratës se si nuk-ka marrur ndonjë vendim që t'i ndihmojë sa do pak mërgates, që ta zgjatë orarin e punës siç kanë bërë komunitat e tjera, apo të punohet dhe të shtuneve me gjysëm orari.

Kam dhe një pyetje për Drejtorin e Administratës lidhur me qështjen e përdorimit të veturave zyrtare jashtë orarit të punës. Kush ka të drejtë prej zyrtarëve komunal ta merr veturën te shtëpia përveq Kryetarit, sepse drejtorët kanë të drejtë vetëm brenda orarit të punës, jo pasi të përfundojë orari?

Dalim tek qështja tjetër që nuk e paskemi këtu as Kryetarin dhe as Nënkryetarin për me na dhënë sqarime, se përse ka dhënë dorëheqje Drejtori i Bujqësis Murat Hoxha dhe është shkarkuar nga puna Drejtoresha e Inspektoriatit. Sipas Drejtoreshës ajo është shkarku, sepse ka inspektu në disa qendra tregtare dhe ka gjetur mall të skaduar, dhe i ka publikuar në Facebook, një veprim i domesdoshëm nga një Drejtoreshë për vetëdijesimin e bizneseve dhe qytetarëve. Nëse është shkarkuar Drejtoresha për këtë arsye, atëherë kjo është skandaloze.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit, Veton.

Sa për informim Kuvendi komunal i ka mbajtur gjithësej 11 seanca: 5- Të rregullta, 3- Të jashtëzakonshme dhe 3-Urgjente. Sa i përket voneses që skemi mbajtur seanca në korrik kemi qenë duke e prit qarkoren e dytë buxhetore dhe është afati i 15, por nga Ministria e Financave nuk i dim arsyet se përse janë vonuar. Kjo është arsyeja përse jemi vonuar.

Labinot Gashi e ka kërkuar fjalën!

**Labinot Gashi:** Përshëndetje për të gjithë ju!

Shqetësimet që i ngritën parafolësit janë evidente siç janë: qështja e mungesës së ujit, mungesa e mirëmbajtjes së ndriqimit publik, lërja në gjysmë të rrugëve dhe vështirësi për me kalu nga ato rrugë. Për qështjet që i cekën më lart është mirë që dhe ne si asambleistë të jemi të informuar se cila është arsyeja për largimin e Drejtoreshës dhe nëse janë ato që i ngriti para folësi atëherë me të vërtet janë shqetësuese.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit, Labinot. Fjalën e ka Halil Morina!

**Halil Morina:** Faleminderit, Kryesues!

Përshëndetje për të gjithë!

Siç e përmendën dhe parafolësit që shqetësim është uji i pijes. Një numër i madh kanë problematik qështjen me furnizim të ujit, jo vetëm për arsye të mungesës së ujit por për arsye të keq menagjimit që bënë hidroregjioni në Malishev. Kërkoj të mirren masa urgjente, sepse shumica e fshatrave janë dalluar për shkak të neglizhencës së hidroregjionit.

Një shqetësim tjetër është që tani është koha e mërgates dhe në këtë kohë bëhet një komunikacion shumë i dendur për shkak se ka makina shumë, por gjithëashtu se nuk i respektojmë rregullat e komunikacionit. Shfrytëzoj rastin të ju kërkoj Stacionit Policor të Malishevës që të dalin të patrullojnë dhe të vendosin pika që rregullojnë komunikacionin. Çështjen e shkarkimit që e përmendën para folësit, Kryetari ka të drejtë të shkarkoj dhe të emëroj çdo kënd, është e vërtet se ne si asambleist kemi të drejtë të pyesim se përse është shkarkuar

drejtoresha ta dimë arsyen, por askush nuk ka të drejtë të spekuloj pa e ditur të vërtetën. Dhe nuk është e vërtetë që është shkarku për arsye të inspektimit të disa marketeve, sepse unë kam qenë dëshmitar në disa raste kur personalisht Kryetari ka insistu që të inspektojnë posaqërisht sezonës së verës, sepse është përqindja më e lartë që të infektohet njeriu. Kështu që ju kisha lut të ju largohemi dezinformimeve dhe spekulimeve.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit, Halil! Fjalën e ka Mirëllinda Gashi!

**Mirëllinda Gashi:** Përshëndetje të gjithë!

Më lejoni njëherë të ju shprehim ngushëllime familjes Sopaj për humbjen e dy mërgimtarëve tanë. Njëheri dua t'ju urojë gjithë mërgimtarëve të cilët gjenden në Kosovë pushime të mira! Të gjitha qështjet që po diskutohen këtu janë të qëlluara, po diskutohet qështja e ujit që ka shumë fshatra që prej vitit 2013 janë vendosur gypat, por asnjëherë nuk kanë pasur ujë. Ndërsa qështjet tjera që janë ngritur këtu përshembull hudhja e mbeturinave në rrugën e tranzitit është në gjendje katastrofale, unë kërkoj dhe njëherë të dalin në teren jo vetëm në qendrën e Malishevës por dhe në fshatra dhe të shihni gjendjen në të cilën jemi.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit, Mirëllinda! Urdhëro, Veton!

**Veton Zogaj:** Halili po thotë që është spekulim, mirëpo nuk ka të bëjë fare me spekulim përderisa nuk vjen Kryetari dhe nënkryetari që të tregojnë arsyen se përse është shkarkuar.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit, Veton! Urdhëro, Halil!

**Halil Morina:** Nëse t'i nuk ka argument që është shkarkuar për atë arsye atëherë kjo është spekulim. Kryetari, nuk është këtu, sepse ka takim me austriak, dhe nënkryetari është në dëgjim publik për buxhetin me shëndetësin. Fakti që ata nuk janë këtu nuk do të thotë që ata kanë ik për mos me u përgjigj në pyetje.

**Argjend Thaçi:** Fjalën e ka Alban Kastrati!

**Alban Kastrati:** Tek qështja e ujësjellsit, nuk e kisha lënë në faj vetëm kompanin e hidroregjionit sepse dy herë e kemi pasur në rend të ditës që të vjen drejtori dhe të na jep sqarime sa i përket ujësjellsit dhe problemeve që po ndodhin rreth ujit nëpër fshatra. Përgjegjësin e mbani ju, sepse ju e keni hequr prej rendit të ditës dhe ne nuk kemi informata drejtë për drejtë prej menaxhmentit të ujësjellsit.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit Alban Kastrati. Urdhëro, Halil!

**Halil Morina:** I nderuari Alban, ne nuk e kemi hequr prej rendit të ditës, por gjithmonë vetëm është shtyr pika të rendit të ditës. Gabimi i jonë dhe i Kuvendit është vetëm që e kemi lënë këtë pikë në fund të rendit të ditës dhe është shtyr. Problemi më i madh qëndron tek ata, sepse nuk është duke u menaxhuar siç duhet ajo ndërmarrje.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit, Halil! Drejtori i Administratës e ka fjalën!

**Fatmir Ademaj:** Faleminderit, Kryesues! Përshëndetje për të gjithë!

Fillimisht te qështja e llaptopëve janë zhvilluar dy procedura, njëra për asamble dhe tjetra për Kuvendin Komunal, konkretisht për zyrtarët që punojnë në komunë. Procedura për llaptop dhe verifikimi ka përfunduar, tani është faza e furnizimit për asamblen komunale ndërsa procedura tjetër për staf të komunës është anuluar dhe duhet të shpallet prapë.

Pyetja që është bërë nga Vetoni se qfar është bërë për mërgimtarët e Malishevës. Iniciativa e parë është që të krijohet një hapsirë kohore, pra dhe në kohë të pazës të punohet në shërbimin e gjendjes civile që të kenë mundësi për nxjerrjen e çdo lloj dokumenti që ju nevojitet. Gjithashtu është lëshuar dhe hapsira e parkingut në oborrin e komunës që të kenë qasje më të lehtë për kryerjen e shërbimeve të tyre.

Sa i përket shfrytëzimit të veturave komunale zyrtari për vetura jep informim të vazhdueshëm, bënë vendosjen e veturës në oborrin komunal pas përfundimit të aktiviteteve që bëjnë zyrtarët, Kryetari dhe Kryesuesi e kanë veturën 24 orë që është në shërbim të tyre me vendim. Në të ardhmen e afërt do ta bëjmë rregulloren si asamble komunale për përdorimin e veturave të zyrtarëve publik.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit, Drejtor! Fjalën e ka Drejtori për Urbanizëm Avdi Morina

**Avdi Morina:** Faleminderit, Kryesues! Përshëndetje për të gjithë!

I ngritët disa shqetësime po filloj nga qështja e rrugës pak a shumë jemi në procedurën pra ne qështjen e sinjalizimit me mirëmbajtjen e rrugëve, kanalizimeve besoj që me lidhjen e kontratave këto probleme do të eliminohen dhe nuk do të ketë më pritje kaq të gjata për intervenime dhe pse kjo është më shumë përgjegjësi e drejtoris së shërbimeve komunale, por ne jemi një qeveri e përbashkët komunale. Tek qështja e ujit të pijës Kryetari i Komunës ka marrë hapa konkret ku është formu task forca që ka për qëllim qështjen me furnizim të ujit të pijes.

Te ndriqimi publik është e vërtetë që shumica nuk funksionojnë, sepse disa i kanë prishur qëllimisht disa janë prishur vet, po ashtu ju e dini që ne si komunë ballafaqohemi me furnizim jo të mjaftueshëm të energjis elektrike dhe kjo pjesë e dëmton shumë rrjetin e ndriqimit publik, mirëpo dhe për këtë janë marrë hapat e nevojshëm, sot është shpall operatori ekonomik për mirëmbajtjen e ndriqimit publik.

Tek asfaltimi i rrugëve kemi probleme nga rritja e çmimeve, shumica e operatorëve që kanë kontrat me nivelin qëndror i kanë shkëput dhe në bazë të komunikimit që kam pasur parashihet që në fund të muajit gusht do të filloj asfaltimi i të gjitha rrugëve në 15 vendbanimet.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit, Drejtor!

E mbyllim pikën jasht rendit të ditës dhe vazhdojmë me rendin e ditës. A ka dikush të shtoj ndonjë gjë tek pikat e rendit të ditës?

Urdhëro Halil Morina!

**Halil Morina:** Ne si grup parlamentar kemi dy propozime: 1- ka të bëjë me një qështje teknike zëvendësimi i një antari të komisionit të aksionarëve të stacionit të autobusave, për arsye të dorëheqjes së antarit Hafir Rexha, meqë është emëru Drejtor andaj ne si grup propozojmë që

Hafir Regja të zëvendësohet Edonjeta Stolliqi. Kërkoj prej juve anëtarë të kuvendit që ta fusim të futet në rend të ditës.

Propozimi 2- Ka të bëjë me një rast të ndjeshum, secili prej neve është në dijeni dhe na ka prek të gjithëve aksidenti i mërgimtarëve nga komuna jonë nga fshati Janqistë, dhe ne si grup propozojmë një ndihmë financiare për këta fëmijë të aksidentuar. Shpresoj që ka me u votuar nga antarët e kuvendit

**Argjend Thaçi:** Faleminderit Halil, Astrit Sertolli e ka kërkuar fjalën.

**Astrit Sertolli:** Faleminderit Kryesues, përshendetje të gjithë!

Po pajtohem edhe unë me Halilin për dy pikat që i propozojë, unë kisha kërkuar që si pikë të rendit të ditës të futet dhe kërkesa e fshatit Bellanicë për lokacionin e ri të varrezave.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit, Astrit!

**Argjend Thaçi:** Fjalën e ka Drejtori i Financave Blerim Thaqi për dhënien e sqarimeve lidhur me propozimin e Halilit.

**Blerim Thaçi:** Faleminedrit, Kryesues! Përshendetje për të gjithë!

Është e vërtet që ka qenë një ngjarje e rëndë, e dhimbshme për të gjithë ne dhe bashkë ndjejmë dhimbje me familjen, dhe pse buxheti nuk është i planifikuar për raste të tilla, por sido që të jetë me vendimin e juaj unë ju siguroj që mjete do të ketë. Kështu që ju kisha kërku me një mbështetje që qfardo që ju e ofroni ta ndihmoni atë familje.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit, Drejtor!

Kemi një kërkes nga zyra e Kryetarit që është propozim për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike përmes shprehjes së interesit të pjesës kadastrale P7231002500223-525 në vendin e quajtur Pallanka-Golesh zona kadastrale Dragobil Kuvendi komunal i Malishevës. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afat gjatë të pronës publike përmes shprehjes së interesit është ngase në të njejtin lokacion Komuna planifikon të ndërtoj qendra për përsona me nevoja të veqanta në nivel të Republikës së Kosovës. Realizimi i këti projekti do të bëhet përmes donatorëve ku të drejtat dhe detyrimet do të specifikohen me kontrat pas miratimit tuaj përfundimtar.

Është dhe kërkesa për formimin e komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së palujtshme publike me qëllim të ndërtimit të qendrës për përsona me nevoja të veqanta. Pra ja 2 pikat e rendit të ditës ndaras. Nëse jeni gati me i hedh në votim kërkesa 01/1223. Kush është për që kjo pikë të hyjë në rend të ditës?

Për: 23

Kundër: 0

Abstenim: 0

Me 23 vota Për, 0 Kundër, 0 Abstenim, kjo pikë hynë si pikë në rendin e ditës.

Propozimi tjetër nga Kryetari ke Formimi i Komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së pakujtshme publike. Kush është për?

Për: 23

Kundër: 0

Abstenim: 0

Me 23 vota kjo pikë hynë si pikë në rendin e ditës.

Propozimi i Halil Morinës ishte: Ndihmë financiare për fëmijët e familjes Sopaj nga Janqisti. Kush është për që kjo pikë të hyjë në pikat e rendit të ditës?

Për: 23

Me vota unanime, hynë në rend të ditës dhe kjo pikë.

Pika e radhës: Zëvendësimi i antarit të Komisionit aksionarëve të Stacionit të Autobusave. Pra zëvendësimi i Hafir Rexhës me Donjeta Stolliqi. Kush është Për që kjo pikë të hyjë në rendin e ditës?

Për: 23

Kundër: 0

Abstenim: 0

Me vota unanime hynë dhe kjo pikë në rendin e ditës.

Pika e radhes është propozimi i Astrit Sertollit: Caktimi i lokacionit për varrezat e fshatit Bellanic.

Kush është për?

Për: 23

Me vota unanime, hynë dhe kjo pikë në rendin e ditës.

Pikat që hynë në rend të ditës janë:

1. Propozimi për miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike përmes shprehjes së interesit të pjesës kadastrale P7231002500223-525 në vendin e quajtur Pallanka-Golesh zona kadastrale Dragobil Kuvendi komunal i Malishevës.
2. Formimi i Komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së palujtshme publike.
3. Ndihmë financiare për fëmijet e aksidentuar të familjes Sopaj nga Janqisti.
4. Zëvendësimi i antarit të Komisionit aksionarëve të Stacionit të Autobusave.
5. Caktimi i lokacionit për varrezat e fshatit Bellanic.

Me ndryshim dhe plotësim të rendit të ditës kush është për?

Për: 23

Kundër: 0

Abstenim: 0

Me vota unanime është miratuar rendi i ditës.

Fjalën e ka Muharrem Morina nga zyra e Kryetarit që të na shpjegojë pikën e parë.

**Muharrem Morina:** Faleminderit, Kryesues!

Përshëndetje për të gjithë!

Me autorizim të Kryetarit të komunës e prezantojë këtë kërkesë të Kryetarit. Qëllimi i Kryetarit është që të ndërtojë një qendër për personat me nevoja të veqanta. Qendra do të ketë shtrirje në nivel Kombëtar për shtetin tonë, kryetari ka biseduar me disa donator të mundshëm që do ta bëjnë financimin dhe juve ju mbetet vetëm të merrni vendim që ta lejoni në shfrytëzim me shprehje të interesit, është një qështje më e komplikuar. Afati sipas Kryetarit është 99 vite, sepse investimi është shumë i lartë dhe siguria duhet me qenë më e lartë. Pasi që ta votoni ju, bëhet shpallja publike aplikojnë personat që shprehin interesin me ndërtu këtë qendër. Pastaj formohet Komisioni vlerësues i shqyrtojnë procedurat dhe ofertën që e ofrojnë ofertuesit e sjellin në kuvend për miratim përfundimtarë, dërgohet prap në ministri dhe pastaj Kryetari mund të lidh kontrat për dhënien në shfrytëzimin afatgjatë të pronës publike, për ndërtimin e kësaj qendre. Pasiqë jepet në shfrytëzim afatgjatë duhet që ju ta caktoni një qera vjetore për arsye se investimi është shumë i lartë nëse nuk caktoni një qera e kemi problem të kalojmë në proces të ligjshmërisë.

**Argjend Thaçi:** Halil Morina e ka kërkuar fjalën, pastaj Veton Zogaj.

**Halil Morina:** Interesi publik për komunën tonë është i dyanshëm. Interesi i parë ka të bëjë me aspektin human, ku ne dëshirojmë që t'i ndihmojmë një kategorie të hendikepuar që janë pjesë e shoqërisë sonë dhe i kanë të drejtat si i kem të gjithë ne. Përveq aspektit human komuna jonë përfiton dhe një shumë të madhe një kapital që do të ndikojë dhe në punësim të shumë personave. Do të ishte një shembull shumë i mirë për komunën tonë, sepse do të ishte mikëpritëse për personat me nevoja të veqanta dhe të ndihen si qytetarët e tjerë të komunës së Malishevës.

**Veton Zogaj:** Faleminderit, Kryesues!

Nuk ka dyshim që është për të mirën e komunës tonë ky projekt, sidomos për personat me nevoja të veqanta që ju lehtëson jetën e tyre dhe i bënë të ndihen të barabart me të gjithë ne. Por fakti që më shqetëson më së shumti është se për gjithë këtë projekt madhështor ne nuk kemi asnjë detaj apo material përpos kësaj kërkesë asgjë tjetër. Unë kisha kërku që si pikë të shtyhet në fund të rendit të ditës që të vjen Kryetari te na jep sqarime më shumë sa i përket këti projekti.

**Argjend Thaçi:** Fjalën e ka Arlind Morina pastaj Valon Krasniqi.

**Arlind Morina:** Faleminderit, Kryesues!

Përsëndetje për gjithë antarët e kuvendit!

Unë mendoj që skemi q ta zgjasim më shumë te kjo pikë, sepse përfaqësuesi i kryetarit Muharrem Morina e sqaroi mirë gjithë procedurën dhe donatorin do ta mësojmë me kohën, nuk është urgjente që ta mësojmë emrin e donatorit kur e dim që është për të mirën e Komunës së Malishevës sidomos për personat me nevoja të veqanta. Ne duhet ta mbështesim këtë.

**Valon Krasniqi:** Idea është shumë e mirë, dhe gjithmonë duhet t'i mbështesim dhe të kemi një bashkëpunim për të mirë të qytetarëve.

**Argjend Thaçi:** Fjalën e ka Alban Kastrati!

**Alban Kastrati:** Faleminderit, Kryesues!

Procedurat na shpjegoi Muharremi dhe i kuptuam të gjitha, mirëpo ajo që është më e rëndësishmja është se jemi me fat që ne si Komunë e Malishevës na u është dhënë kjo mundësi dhe këtë mundësi nuk do lejojmë që të na humb. Duhet të ja hapim dyert këti projekti dhe ne si grup i PDK-ës e përkrahim këtë projekt.

**Argjend Thaçi:** Fjalën e ka Halil Morina

**Halil Morina:** Meqë ne duhet të i vendosim në këtë vendim dy kriteret bazike që është Afati kohor dhe qeraja, ne si grupë parlamentar afatin kohorë siç e ka kërkuar Kryetari ne kërkojmë që të jepet për 99 vite dhe qeraja në hapsirë prej dy hektarësh të jetë 2 euro në vit.

**Argjend Thaçi:** Fjalën e ka Valon Krasniqi.

**Valon Krasniqi:** Unë kisha mendu që edhe klubit të i jepet qeraja me 1E ose 2E, sepse nëse e llogarisim 4200 që i kemi dhënë klubit për 15 vite 72.000E dhe nuk po dim a i kemi ndihmu apo jo.

**Argjend Thaçi:** E hedhim në votim propozimin e Kryetarit me këto kriteret qeraja vjetore 2E, periudha kohore 99 vite. Miratimi paraprak për dhënien në shfrytëzim afatëgjatë të pronës publike përmes shprehjes të interesit publik të pjesës së ngasës kadastrale P7231002500223-525 në vendin e quajtur Pallanka-Golesh zona kadastrale Dragobil në Malishevë. Kush është për?

Për: 22

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me 22 vota për, 0- kundër, 1- abstenim kalon kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë te pika dytë: Formimi i Komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së palujtshme publike me qëllim të ndërtimit të qendrës për personat me nevoja të veqanta. Ky komision përbëhet prej 5 antarëve, 2 nga kuvendi, 2 ekzekutivi dhe 1 të shoqëris civile. Nga zyra e Kryetarit është Bashkim Krasniqi dhe Avdi Morina, ndërsa nga OJQ është Feride Hoxha. Kërkoj dhe dy anëtar nga kuvendi. Urdhëro Halil Morina!

**Halil Morina:** Unë propozoj Astrit Sertollin.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro Arlind Morina!

**Arlind Morina:** Nga LDK propozojë Halit Lima.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Burim!

**Burim Paqarizi:** Unë propozoj, Alban Kastratin.

**Argjend Thaçi:** Kush është për që Astrit Sertolli të jetë anëtar i Komisionit?

Për: 21

Kundër: 0

Abstenim: 2

Hamit Lima është propozimi i dytë, kush është për që të jetë anëtar i komisionit?

Për: 16

Kundër: 7

Abstenim: 1

Kush është për që Alban Kastrati të jetë anëtar i komisionit?

Për: 18

Kundër: 0

Abstenim: 5

**Argjend Thaçi:** Në mbledhjet e kaluara për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit dy propozimet e para që janë bërë dhe që kanë marrë vota të mjaftueshme për të qenë anëtar ata janë zgjedhur dhe është plotësu numri, nuk ka vazhdu votimi më për propozime të tjera.

Fjalën e ka Hamit Lima!

**Hamit Lima:** Alban unë po tërheqja prej propozimit për anëtar.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro Arlind Morina!

**Arlind Morina:** Kjo nuk është fakt por realitet që gjithmonë LDK-ja ka qenë shkollë politike dhe e përgëzoi Hamit Limën që bëri tërheqje dhe ju tregoj që kështu duhet të vazhdohet në kuvend. Faleminderit!

**Argjend Thaçi:** Faleminderit, Arlind!

Po vazhdojmë me leximin e emrave të anëtarëve të komisionit 1. Bashkim Krasniqi, 2. Avdi Morina, 3. Feride Hoxha, 4. Astrit Sertolli, 5. Alban Kastrati.

Kush është për?

Për: 23

Kundër: 0

Abstenim: 0

Me vota unanime, formohet komisioni për dhënie në shfrytëzim të pronës së palujtshme publike me qëllim të ndërtimit të qendrës për personat me nevoja të veqanta.

Pika e radhës është: Shqyrtimi i raportit të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Qërshor 2022. Për të prezantuar këtë pikë ftoj Drejtorin për Buxhet dhe financa Z. Blerim Thaçi.

**Blerim Thaçi:** Faleminderit Kryesues. Buxhetin në këtë raport e keni të paraqitur sipas aprovimit që e keni bërë në janar të këtij viti. Qështja e alokimit të mjeteve për periudhën 6 mujore ka qenë 11,445,029.29E që në përqindje alokimi i buxhetit ka qenë 72.88%. Sipas shenimeve në librin e thesarit shkalla e shpenzimit të buxhetit të realizuar në bazë të alokimit ka qenë 58.33% që kap vlerën me 6,675,598.28E, ndërsa në përqindje të totalit të buxhetit si realizim i shpenzimit arrin vlerën në 42.51%. Kryesisht realizimi i shpenzimit ka qenë në muajin Maj-Qershor mirëpo është gjendja aktuale që e kemi nxjerr dhe për Muajin Korrik sepse realizimi i shpenzimeve në shumën më të madhe ka qenë në korrik. Shpenzimi i buxhetit në nivel total të buxhetit deri më tani arrinë përqindjen në 50.95 % deri në fund të korrikut. Ajo që është në interes të veçantë është qështja e shpenzimeve kapitale e cila deri më tani si shpenzim është 27% mirëpo duke përfshirë shpenzimet dhe zotimet për muajin korrik ka përqindjen afër 52%. Totali i buxhetit në dhjetor duke përfshirë dhe zotimet është 61.28%. Me realizimin e të hyrave në këtë periudhë 6 mujore jemi të kënaqur, sepse janë grumbulluar mjete në vlerë prej 668,476.22E për afërsisht realizimi i të hyrave është 65%. Të tjera të dhëna janë të shënuara në raport sipas Drejtorive dhe sipas kategorisë nëse ka ndonjë gjë për të pyetur urdhëroni. Tek shpenzimet e karburanteve është e ditur Veton që këtë vit ka shpenzime më të larta, për arsye se dhe qmimet janë më të larta.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit Drejtor për prezantimin. Hapi debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. Valon Mazreku e ka kërkuar fjalën, pastaj Veton Zogaj.

**Valon Mazreku:** Faleminderit, Kryesues!

Kryesisht Raporti paraqet një përmbledhje të aktiviteteve të të gjithë drejtorive, se sa kanë punuar deri më 30 qershor. Është një përmbledhje ekzekutive e pasurime në numra, ajo që është përparësi e këtij Raporti është që kemi një ngritje të nivelit të inkasimit të të hyrave komunale. Këtë kontribut në radhë të parë ju jap qytetarëve të komunës së Malishevës që janë të përgjegjshëm ndaj obligimeve komunale që ata i kanë, dhe në radhë të dytë qeveria komunale që i ka nxitë që t'i përfundojnë këto obligime që i kanë ndaj komunës. Ishte një rritje duke pasur parasysh që viti 2022 pragu i të hyrave vetanake është në nivel më të lartë se në vitin e kaluar. I përmendi Drejtori karburantet duke i dhënë përgjigjje Vetonit është e vërtetë që afër 70% është ngrit qmimi i karburantëve, kjo pasqyrohet tek shpenzimet dhe ndoshta matësi real do të ishte se sa është hargjuar në litër se në çmim. Unë e kam pasur një shqetësim në bazë të raportit, nivelin e shpenzimeve të buxhetit tek kategoria e investimeve kapitale ku deri më 30 qershor ka qenë në nivel të ulët të shpenzimeve të buxhetit me 16%, mirëpo Drejtori e dha një arsyeshmëri që buxheti është aluku në periudhë më vonë jo në kohën që është dashur të alukohet dhe kjo e ka penguar zhvillimin e investimeve kapitale, mirëpo tanimë është ngrit niveli i shpenzimeve të buxhetit tek investimet kapitale gjatë muajit korrik rreth 27%. Uroj që niveli i shpenzimeve të buxhetit të arrij nivelin maksimal, për arsye se vetëm atëherë kur shpenzohet buxheti nënkupton që është punuar në komunë. Dhe ju kisha lut drejtorive përkatëse për çdo projekt që kanë fillu që t'i përfundojnë sa më shpejt, mbrenda afateve që i kanë të përcaktuar dhe të fillojnë të iniciojnë

procedurat për projekte të reja të cilat janë një sasi e madhe dhe në vlerë monetare, për të cilat unë nuk kam parë që janë inicu procedura.

**Argjend Thaçi:**Fjalën e ka Veton Zogaj!

**Veton Zogaj:** Po i ceku disa shqetësime që i kam shprehur dhe në mbledhjen e KPF-s, e para pajtohna me Valonin që na gëzon fakti që Komuna këto vitet me radhë prej dy viteve më parë e tash ka fillu të bëjë një inkasim të të hyrave vetanake në raport me vitet e më hershme. Çka më shqetëson është që shumë prej drejtorive kanë nivel të ulët të shpenzimit të buxhetit për projektet që i kanë pasur në realizim ose në të cilat i kanë parapar në buxhet për me i realizu. I kanë pasur mjetet, por nuk i kanë shfrytëzuar dhe në momentin që nuk shfrytëzohen ato mjete është një keq menaxhim nga ana e tyre. Te investimet kapitale niveli i realizimit të projekteve është shumë i ulët afër 27% pra jemi në muajin gusht, ndërsa niveli i realizimit të projekteve është 27% është shumë shqetësuese.

Shqetësim tjetër është te Drejtoria e Shëndetësisë e cila ka pasur në raport të paraqitur afër 80% të realizimit të shpenzimit të buxhetit, ndërsa nuk ka realizu 3 projektet që i ka pasur në këtë projekt buxhet të cilat janë: Ndërtimi i pullazit të shtëpisë së shëndetit QKMF, Ndërtimi i garazhdave të QKMF-s, Rregullimi i oborrit të QKMF-s. 0E shpenzim për këto, ndërsa këtu po figuron që buxheti është i shpenzuar. Kam dhe disa pyetje: Pse figuron 0E në raport tek të hyrat e qërtifikatës kur për këto paguhet 1E pse nuk ka të hyra në këtë kategori?

Pranimi teknik i lokaleve prapë qëndron të hyrat 0E në këtë kategori.

Është inspektimi higjienik sanitar, a bënë Drejtoria e Inspektoriatit inspektimet higjienike të objekteve publike a i japin gjobë, sepse në shumë objekte sidomos në shkolla kanë shumë papastërti dhe a i është dhënë gjoba ndonjëherë qendrave tregtare sepse dhe në këtë drejtori të hyrat janë 0E?

Të hyrat nga agjensioni i pyjeve që i jep gjoba, por që prapë figuron tek të hyrat 0E?

Një sqarim tek shpenzimi i buxhetit për kategorin ekonomike këtu po figuron paga për vendime gjyqësore a është paga për gjykatës e prokuror apo është vendimi që i ka humbë rastet, është shumë shqetësuese që kjo shumë e madhe është humb nga vendimet gjyqësore.

Sa i përket shpenzimeve për karburant po e arsyetojmë me faktin që janë ngrit çmimet e naftës sidomos 6 mujorin e fundit, mirëpo shpenzimet për shujta në raport me vitin e kaluar janë 10,000E më shumë, regjistrim i veturave ka dyfishim, sepse në vitin e kaluar kanë qenë 7,476.41E ndërsa këtë 6mujorsh janë 14,774.53E.

Mirëmbajtja e ndërtesave vitin e kaluar kemi shpenzuar 21,045.34 tani i kemi 55,065.89E.

Rregullimi pastrimi i Lumit Mirusha 10,000.00E ka mbetje, ujësjellësi në fshatin Bellanicë është 28% i realizim.

Po rikthehna prapë tek qështja e gjykatës, a ka ndonjë mënyrë që të dalim nga kjo situat, unë e kam pasur një takim me Ministrin e Financave dhe ai ka thënë që Komunës së Malishevës ju është sjell një deklaratë që zotohet Komuna që nuk i humb pagat për mësimdhënës, pra në momentin që e nënshkruan komuna deklaratën që zotohet që deri në fund të vitit nuk mbet mbrapa me pagesen ndaj mësimdhënësve, atëherë realizohet paga jubilarë dhe pagat përcjellëse për këtë kategori.

Nëse nuk e nënshkruan Komuna atë deklarat është vetë nxitje për dërgimin e rasteve tek përmbauesit.

**Argjend Thaçi:** Alban Kastrati e ka kërkuar fjalën.

**Alban Kastrati:** Tek shpenzimet për antarësim unë nuk po e kuptoj për qfar antarësimi është, në vitin 2021 është 0E ndërsa tani është 3,500.00E.

Furnizim për pije dhe ushqim në vitin 2021 kanë qenë 64,595.51E ndërsa tani është 74,087.47E, Karburante për vetura në vitin 2021 kanë qenë 21,121.66E ndërsa në vitin 2022 janë 50,346.16E. Mirëmbajtja e banesave në vitin 2021 ka qenë 21,045.34E ndërsa tani është 55,065.89E.

Një pyetje kam për Drejtorit të Administratës apo të Urbanizmit kjo është jashtë rendit të ditës bari në hyrje të komunës që është bërë në gjendje shumë të keqe, përse nuk kërkon nga puntorët teknik që ta mirëmbajnë.

**Argjend Thaçi:** Arlind Morina e ka fjalën!

**Arlind Morina:** Pajtohna edhe unë me kolegët e tjerë që të hyrat duhet të vlerësohen dhe shpenzimet minimizohen. E kam një pyetje te projektet kapitale tabela 8.7 projekti 51069-rregullimi i oborrit të shkollës fillore Astrazup. Drejtorë a ka datë të caktuar se kur do të filloj ky projekt siqçe dimë oborri i shkollës është në gjendje të mjerueshme dhe më pak se një muaj fillon procesi i mësimi, kushtet atmosferike do të ndryshohen dhe do të ketë vështirësi që ata nxënës ta vijonë mësimin në ato kushte.

**Argjend Thaçi:** Nëse nuk ka pyetje më ftoj Drejtorin për Buxhet dhe Financa që t'i përgjigjet pyetjeve që i keni bërë.

**Blerim Thaçi:** Faleminderit!

Sa për informim përveq asaj që ka fillu shpenzimi te investimet kapitale në maj-qeshor, ne në maj jemi ndal në planifikimin e shpenzimeve, sepse për herë të parë këtë vit bëhet planifikimi i shpenzimeve të çdo shpenzimi për qdo muaj. Ne kryesisht shpenzimet kapitale i marrim nga Drejtoria e Urbanizmit dhe ata i prezantojnë se kur duhet të përfundojnë punimet dhe ne në bazë të atyre e bëjmë planifikimin e shpenzimeve në qdo muaj. I përmendi dhe Valoni dhe qështjet që janë në procedur ka që janë nxjerr dhe me vendime 2 vjeqare, por ne do të ndalemi në shpenzimet e këtij viti që pothuajse e kanë vlerën mbi 2.000000E që janë në procedur dhe në përfundim siç është pullazi dhe renovimi i shëndetësis. Sipas prezantimit të Urbanizmit për planifikim shpenzimi periudha e fundit do të jetë e Shtatorit ose më së largi në Tetor, sepse aty është një projekt 3 vjeqar. Të hyrat vetanake tek të gjitha kategorit ka pasur ngritje të qmimeve nuk është që ka pasur vetëm tek Karburantet, dhe tek rasti që përmendi Albani shpenzimet për antarësim kemi përfunduar obligimet e antarësis së vitit të kaluar përshembull tek asociacioni i komunave dhe të këtij viti dhe këto hynë si shpenzime të vitit 2022. Qështja e qertifikatave sigurisht është evidentuar tek pjesa e qertifikatave të tjera në një rubrikë më poshtë sepse qertifikatat e kanë të njëjtën vlerë dhe hynë me një uniref.

Tek vendimet gjyqësore shuma totale që është cekur aty është edhe e ekzekutivit, të shujtave, të

pagave jubilarë, dhe të pagave përcjellëse. Ne si Komunë dhe asociacioni i komuave i kemi filluar procedurat e kallzimit penal ndaj ministris së arsimit dhe ministris së shëndetësis për realizimin e të drejtës që është duke u ushtruar me vendim dhe nënshkrim nga qeveria jo nga Komunitat.

Arlind janë në procedur shumë projekte , tani e kemi dhe mirëmbajtjen e shkollave, rregullimin e disa oborreve të shkollave, në banjë kanë filluar procedurave dhe në Astrazup presim që të ja fillojnë. Janë disa projekte që nuk kanë ardhur vendimet nga zyra e Kryetarit. Kemi qështjen e realizimit të urës në Mirushë rrugën për Gurbardh por me mjetet që e kemi planifikuar është e pa përballueshme me realizu, jemi duke e shqyrtuar mundësin ose me shku si një investim dy vjeçar, por te ura nuk mundet me u paraparë një gjë e tillë, sepse nuk duhet të pengohet komunikacioni. E kemi dhe pritjen e realizimit të fillimit të procedurave të shkollës në Turjakë është një lajmë i mirë për ne sepse me kërkesen e Kryetarit për ministrin e arsimit pritet që të bëhet investimi nga Ministria e Arsimit. Gjithashtu e kemi dhe realizimin e rrugës që e ka marrë mbisipër Ministria e Zhvillimit Ekonomik rruga Gurbardhë-Turjakë.

**Argjend Thaçi:** Fjalën e ka Valon Krasniqi.

**Valon Krasniqi:** Në këtë raport ne shohim projekte që çdo vit i kemi përfshirë në buxhete që i kemi votuar, por ne nuk i kemi specifikuar rrugët kurse këtu çdo fshat apo lokalitet po shenohen në detaje që do të rregullohen dhe kjo është ajo që kërkojë nga ekzekutivi që secila rrugë që është shenuar këtu të mos të devijohet, sepse çdo njeri është duke pritur që ato rrugë të rregullohen sa më shpejtë dhe mos të ketë probleme.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit Valon, atëher nëse nuk keni ndonjë gjë për të shtuar për këtë pikë të rendit të ditës e mbylli debatin për këtë pikë të rendit të ditës. Shkojmë në pauzë dhe kthehemi në ora 13:30 prap. Vazhdojmë me pjesen e dytë tek pika e radhës e cila është shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës 11/1298 të datës 22/06/2022 të Drejtoris për Arsim dhe Edukim për miratimin e propozimit për ndryshimin e thirrjes shkolla e mesme profesionale “ Lasgush Poradeci” në Kijevë me Institucionin e Arsimit dhe Aftësimin profesional “IAAP” “Lasgush Poradeci” në Kijevë. Konfirmojë që në sallë jemi 18 asambleistë që do të thotë kemi korum me vazhdu me punimet. Ftoj Drejtoreshen e Arsimit që të merr fjalën dhe të prezantojë pikën e rendit të ditës.

**Arbëresha Krasniqi:** Faleminderit Kryesues, përshëndetje koleg, asambleistë!

Për mua është nder që sot të paraqes kërkesen para jush që të aprovohet nga ana e juaj ndryshimi i statutit të shkollës së mesme profesionale “ Lasgush Poradeci” në Kijevë në Institucionin e Arsimit dhe Aftësimin Profesional “ IAAP”. Kjo kërkesë është nga Drejtoria e Arsimit në drejtim të Ministris të MASHT-it konkretisht që të na mundësoj drejtimet mjekësore në shkollën e mesme profesionale “Lasgush Poradeci” në Kijevë. Në diskutim e sipër me Ministrin me përfaqësuesit ligjorë që janë në Ministri, ata i kanë paraqitur kriteret e tyre që t’i mundësohet Komunitës së Malishevës drejtimet e Ministris. Duke e parë trendin e interesimit të fëmijëve për drejtimet mjekësore të Komunitës së Malishevës që i drejtohen komunave të tjera për vazhdimin e

shkollës së mesme për drejtimet mjekësore, vetëm vitin e kaluar nga Komuna jonë kanë kaluar në komuna të tjera 24 nxënës, për këtë arsye ne kemi bërë kërkes tek MASHT-i pasi që ka një numër të mjaftueshëm të nxënësve për këtë drejtim. Mirëpo kërkes e tyre ka qenë që shkolla e mesme “Lasgush Poradeci” në Kijevë të ndryshojë emërtimin e saj nga shkolla e mesme profesionale ekonomike-juridike “ Lasgush Poradeci” në shkollën e Institutit të Arsimit dhe Aftësisimit profesional “ IAAP”. Duke i lexuar benefitet që merr shkolla me këtë statut dhe duke parë interesimin dhe mundësin për të ju dhënë Prindërve dhe fëmijëve tanë që të studiojnë drejtimet e mjekësis, ne jemi zotuar para MASHT-it që kjo shkollë do ta merr aprovimin, sepse kjo ka qenë dhe kërkes e vet shkollës e komunitetit në përgjithësi. Shkollës nuk i ndërrohet emri por i ndërrohet vetëm statuti kjo do të ndikoj edhe te prindërit pasi që do ti kenë fëmijët e tyre afër dhe do të ndikojë në zvogëlimin e shpenzimeve ekonomike. Ministria e Arsimit i ka besuar premtimit tonë që kjo shkollë të merr aprovimin nga asamblea Komunale dhe në mënyrë të besueshme e ka lejuar një klasë e cila përbëhet nga 24 nxënës që ta përfundojnë shkollimin e mesëm të drejtimeve mjekësore që në vitet e ardhëshme të kemi më shumë mundësi ideale në drejtim të shkollimit të mesëm në mjekësi të përgjithshme. Unë kërkoj që ta aprovoni kërkesën e drejtoris së arsimit që është e domosdoshme për rrjedhojën e punës dhe për mundësin e funksionimit të këtyre fëmijëve që janë pranuar tashmë në klasën e 10 për drejtimin e mjekësis.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit Drejtoreshë!

Halil Morina e ka kërkuar fjalën pastaj Labinot Gashi.

**Halil Morina:** Mendoj që është lajmi më i mirë për kushtet e arsimit për hapjen e këti drejtimi, duke pasur parasysh nevojën e madhe për profesionist shëndetsor që ka komuniteti jonë. Të gjithë e dimë që profesionistët tanë janë duke u larguar nga shteti jonë në shtetet të tjera Evropiane, dhe sa më shumë që kemi mundësi të shtojmë profesionista shëndetësor është më mirë për ne. E cekim dhe Drejtoresha që më fëmijët tanë nuk kanë nevojë që të shkojnë në komuna të tjera për vazhdimin e shkollimit për këtë drejtim por ta kemi shkollën tonë. E shfrytëzoj rastin Drejtoreshë që të falenderojë për angazhimin tënd që ke bërë në këtë drejtim. Mendoj që pas këti angazhimi të madhë për me arrit deri këtu ne duhet ta mbështesim dhe ta aprovojmë këtë kërkes.

**Argjend Thaçi:** Labinot Gashi e ka fjalën.

**Labinot Gashi:** Përshëndetje për të gjithë!

Besoj e dini të gjithë që dhe unë punoj qe disa vite në këtë shkollë. Drejtoreshë pyetja ime ka të bëjë me kërkesën më së pakti i takon shkollave që të marrin iniciativ të tillë, nëse e keni lexuar kërkesën të cilën e ka bërë ushtruesi i detyrës së Drejtorit që realisht nuk ka të drejtë, për shkak të pozicionit. Drejtorja detyrohet me i zbatu të gjitha ligjet dhe udhëzimet e MASHT-it me këtë pajtohemi, dhe këtu nuk po shenon vetëm për shkollën e “Lasgush Poradeci”, por të gjitha shkollat profesionale duhet të integrohen në IAAP. Unë e kam parë dosjen, shqetësimet që i kanë ngritur kolegët së bashku me mua janë reale për arsye se shkolla jonë është e pamvarur që nga viti 1990 dhe më tregoni se qfarë keni bërë për këtë shkollë qe 3 mandate që i keni pasur, dhe kjo nuk është kërkesë që të zbatohet në kuvend, nëse është kërkesë e MASHT-it drejtoresha duhet

me e zbatu por jo vetëm për shkollën tonë. Është ligji prej vitit 2013 që i obligon të gjitha shkollat profesionale të Kosovës që të hynë në kuadër të këti institucioni. Pytja ime është kjo qfar keni bërë me konkursin që e keni shpallur për regjistrim të semimaturantëve në 3 shkollat në Drenoc, a kanë nevojë që me e defino statusin këto shkolla plotësisht pajtohna, por prej 900 semimaturantëve ju e keni hapur konkursin për 20 paralele në Gjimnaz dhe nuk keni menduar për këto dy shkollat e tjera ku do të marrin nxënës këto. Ne 4 gjenerata i mëshojmë vullë diplomave me shkollë profesionale gjimnazit shkenca natyrore dhe shoqërore duke i dhënë dhe vërejtje ministris pa marr parasysh cilit subjekt politik i takon, nëse mbas një kohe mirret ndokush me këtë qështje do të shkojë në përgjegjësi penale sepse është shkelje. Po e lexoj kërkesën MASHT nr:2/3726 data: 28.08.2019 pika 1. Të gjitha shkollat profesionale të Republikës së Kosovës janë të obliguar të ken emërtimin e tyre IAAP, ku obligohet shkolla dhe Komuna të rregulloj statusin e tyre duke u bazuar me profilet dhe sektort që mbulojn duke i respektuar kërkesat e rregullta të punës dhe nevojës për zhvillim Komunal. Nëse është kërkes për krejt Republikën e Kosovës nuk kemi çka me diskutu.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Drejtoreshë!

**Arbëresha Krasniqi:** Labinot, me ardhë prej asaj shkolle është shumë jo profesionale për debatin që bëre po ta shpjegojë përse, nuk ka lajthitje përkundrazi ka insistim të vendit që ajo shkollë të fuqizohet fillimisht me numër të nxënësve dhe e dyta me mundësi ideale dhe fizike. Ministria e Arsimit e obligon Drejtorin e Arsimit që të merr vendime të tilla në bashkëpunim me asamblenë komunale. Të gjitha llojet e shkollave profesionale në Republikën e Kosovës janë të obliguara të kenë emërtimin e tyre IAAP duke i nënshtuar vendimit të tyre profilet që IAAP i zhvillon. Arsyetim: Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë si dhe në bazë të kërkesave të Komunave për emërtimin e shkollave profesionale deri në përfundimin e procesit të miratimit të dokumentit kornizë e korikulit në sistemin e IAAP-së si dhe akte nënligjore që i rregullojnë fushat në fusha, programet dhe kualifikimet me kodifikime ndërkombëtare si IS CED FOET dhe ISCO janë këto institucione ndërkombëtare që na ndihmojnë publikisht dhe me mbështetje të plotë të ministris së Arsimit, shkollave apo institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional. Obligohen të gjitha shkollat dhe komunat të rregullojnë statutin e tyre bazuar në profile dhe sektore që mbulojnë duke respektuar kërkesat e tregut të punës, nevojat për zhvillim Komunal duke respektuar në përputhshmëri të plotë legjislacionin në fuqi, prandaj vendos se cilën dispozitiv të këti vendimi. Ndërsa kërkesa juaj dhe e MASHT-it drejtuar DKA-së është tjetër. Kjo është kërkesa e shkollës që parimisht duhet të rregullohet si kërkes e shkollës të vjen në Drejtori të Arsimit është me procedura të rregullta nuk e penalizon, është komplet dezinformate që e penalizon pozicioni i detyrës që të bëjë kërkesa të tilla me pa përmbajtje dhe jo reale. Nuk ka tendenca me mbyll shkollën si po thua t'i është komplet e kundërta. Ndërsa rreth diskutimit që janë hap 20 paralele në gjimnazin "Hamdi Berisha" dhe çka është bërë me "Lasgush Poradecin" dhe çka me Qendrën e Kompetencës në të gjitha gjimnazet e shkencave natyrore dhe shoqërore në Republikën e Kosovës kanë të drejtë regjistrimin dhe nuk mundësh të ja mohosh fëmieve të cilët e kanë rezultatin shumë mirë dhe shkëlqyeshëm. Ne kemi përdor

kriterin që është përdorë dhe herave të tjera ,vetëm dy raste të fëmieve të cilët kanë qenë binjakë, janë dy binjakë me sukses të shkëlqyeshëm, dhe dy binjak me sukses të mirë, kërkesa e shkollës ka qenë që a me vazhdu dhe këta binjak me sukses të mirë në gjimnazin “Hamdi Berisha”, aprovimi i DKA-s ka qenë po, sepse ata janë Binjakë. Vetëm dy raste kanë qenë me sukses të mirë të gjitha të tjerat janë me sukses të shkëlqyeshëm dhe shumë mirë. Dhe kjo ka ndodhë për me ja shtu kredibilitetin gjimnazit shkenca natyrore që ndodh jo vetëm në komunën e Malishevës por dhe në Komuna të tjera të Kosovës dhe njëkohësisht për me i dhënë mundësi dhe Qendrës së Kompetencës dhe shkollës “Lasgush Poradeci” në Kijevë. Ndryshimi i statutit nuk nënkupton emërtimin e shkollës, nënkupton ndryshimin e statutit që është dhe me mundësit e dëftesave. Dëftesat që do ti marrin fëmijët në këtë shkollë do të njihen ndërkombëtarisht sikurse që e ka statutin Qendra e Kompetencës vetëm që dallon që kjo shkollë është në menagjimin e Komunës, ndërsa shkolla si Qendra e Kompetencës janë në menagjimin e agjensioneve.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit Drejtoreshë! Veton Zogaj e ka kërkuar fjalën.

**Veton Zogaj:** Faleminderit, Kryesues!

Çka unë e kuptova Labinoti nuk është kundër kërkesës, por që nuk është dashur të silltet në Kuvend. Sa i përket qështjeve tjera Halili tha që është punuar shumë për hapjen e drejtimit të infirmjeris në shkollën “Lasgush Poradeci” në Kijevë, mendoj që është vendim i Ministris që ju ka drejtuar të gjitha shkollave profesionale, nuk ka bërë përjashtim vetëm për Komunën e Malishevës, mirë që ka punuar Drejtorja në këtë drejtim dhe i ka marrur hapat. Në njoftimin e Drejtoris që është hapur konkursi, kërkohet një mësimdhënës për 16 orë në shkollën profesionale për lënden e infirmjeris, a nënkupton që kjo paralele e ardhshme që lënda e mjeksis ka me qenë vetëm infirmjaria me këto 16 orë që do të jetë vetëm një mësimdhënës dhe nuk ka me pas tjetër mësimdhënës?

Ndërsa sa i përket qështjes së numrit të nxënësve është e vërtet që është shqetësimi, ne kemi kërkuar raportin nga DKA që nuk është sjellur nuk e dimë arsyen përse, që me e pa ne gjendjen sa semimaturantë i kemi pasur, sa drejtime janë hapur në gjimnaz dhe sa në dy shkollat e tjera të mesme, sa janë regjistruar në gjimnaz dhe në shkolla tjera me qenë të gjitha të dhënat në raport, ndoshta ke ndonjë arsye se përse nuk është ardhur raporti ende.

**Argjend Thaçi:** Mirëllinda Gashi ka kërkuar fjalën pastaj Halil Morina.

**Mirëllinda Gashi:** Faleminderit Kryesues!

E dëgjova Drejtoreshën që e mbajti fjalimin, unë jom bazuar vetëm tekligji te pjesa e parë që thotë sipas ligjit jemi të obliguar që Kuvendi komunal të mirret me këtë qështje, pra nuk mundemi me i ik ligjit nuk kemi çka diskutojmë më shumë ne vetëm do të bisedojmë dhe një herë me grupin dhe do të vendosim. Ndërsa sa i përket regjistrimit të nxënësve sa për informim këtë vit Qendra e Kompetencës qëndron shumë mirë.

**Halil Morina:** Nganjëherë nuk po mundem me i kuptu disa pyetje që po i bëni përshembull si ndryshohet statuti i shkollës aty shenon shkolla me komunën, shkolla e bënë kërkesën dhe

komuna jemi ne. Pyetja tjetër këtu qfar lëndë të tjera do të ketë ky program është pyetje amatoreske kjo, ekziston një korrikul që e ka Ministria e Arsimit që për secilin drejtim tregon qfar lënd ka. Dhe një gjë tjetër sa herë që e hapim nja qështje të arsimit na hapet një problem i madh, ne jemi duke diskutuar vetëm për një qështje ndryshimi i statutit të shkollës ne nuk jemi duke folur për konkurse të nxënësve dhe të mësimitdhënësve, jemi duke folur për qështje specifike.

Te pyetja se përse nxënësit nuk po vinë në shkollën tonë, këtë pyetje bënjani vetës jo të tjerëve. Nëse ndonjë shkollë kish shkel kriteret për pranimin e nxënësve, atëherë ne kishim marr masa por nëse sipas kriterëve pranohen nxënësit në Gjimnaz, nuk mundemi që të ndërhyjmë dhe t'i obligojmë nxënësit të shkojnë në një shkollë tjetër.

**Argjend Thaçi:** Alban Kastrati e ka kërkuar fjalën.

**Alban Kastrati:** I kam dy qështje. E para unë për këtë pikë të rendit të ditës nuk kam material pra nuk mundem me thënë asgjë. Vetëm një pyetje ja kisha bërë Drejtoreshës lidhur me shkollën në Kijevë, çka do të ndodhë me stafin, me mësimitdhënësit a do të bëhen me dy ndërrime apo çka, se nuk po e kuptoj këtë?

**Argjend Thaçi:** Veton Zogaj ka kërkuar replik, pastaj Labinot Gashi.

**Veton Zogaj:** Halil, për me kuptu se çka po thotë tjetri duhet me ndëgju e mos me kriju situata dhe improvizime dhe devijime të debatit, unë i shpreha disa shqetësime konkrete dhe i bëra në formë të pyetjes nuk e kritikova Drejtorinë e Arsimit për asgjë, kërkoja vetëm sqarime. Pyetja e parë që i bëra është: Ky vendimi që është marr nga sekretari i Drejtoris së Arsimit në atë kohë dhe tash Kryetar i Komunës Ekrem Kastrati a nënkupton që është vendim që nuk ka nevojë që të diskutohet në asamble, por vetëm të zbatohet nga ana e Drejtoris. Pyetja e dytë sa i përket paralelës së mjekësis e kam parë konkursin që është hap vetëm një vend për mësimitdhënës në lëndët e këti drejtimi, a ka me pasur një hapje të konkursit të ri për mësimitdhënës apo ka me vazhdu vetëm ai mësimitdhënës me i mbajtë orët e mjekësis.

**Labinot Gashi:** Faleminderit, Drejtoresh! Nuk e thash që jam kundër kësaj kërkesë vetëm thash që kërkojmë nga Drejtoria t'i zbatoj ligjet e MASHT-it, e ceke qartë të gjitha shkollat profesionale jo vetëm një shkollë. Atë që the nuk mundem me ja imponu nxënësve shkollën se ku me i dërgu ajo është e vërtet, askush nuk mundet me ja imponu një gjë të till, por në konform të udhëzimeve administrative nëse nuk është raporti 30-70 në favor të shkollave profesionale atëher më thuaj që unë skam të drejtë. Halili tha që nuk po punohet në shkolla, Arbëresha është Drejtoresha e jonë dhe e shkollës së Gjimnazit e kemi udhëheqëse leta monitoron shkollën le të shikon se kushë po punon dhe kush jo. Mandatin që e ka fituar Drejtoresha e dinë që nuk ka qenë gjendja e arsimit e mirë dhe nuk ka pasur drejtorë në shkollë dhe kam inkurajuar që të bëjë zgjidhje, por që nuk është bërë ende. Unë vetëm po i ngriti shqetësimet e mia dhe po kërkoj nga Drejtoria e Arsimit që t'i zbatojnë ligjet e MASHT-it.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Drejtoreshë!

**Arbëreshë Krasniqi:** Labinot, nëse të kanë ndëgjuar asambleistat në diskutimin e parë dhe në diskutimin e dytë komplet ka një shpërfaqje në atë që e ke thënë. E para the që po trumbetohet si rezultat që është lejuar Drejtimi i mjekësis në Kijevë, nuk është trumbetim kjo është një realitet duke ju ofruar fëmive një mundësi që të përfundojnë shkollën e mesme të mjekësis në Kijevë, që të mos shkojnë në Komuna të tjera. Ju kem ofru Prindërve të atyre fëmieve një mundësi emocionale dhe subjektive që ta kenë mbikqyrjen e fëmieve të tyre më afër. Shpenzimet mujore që i kanë ofruar prindërit për ti derguar fëmiet e tyre për shkollim në komunat e tjera apo në shkollat private kanë qenë jashtzakonisht të mëdha. Këtyre 24 fëmieve që ju ka lejuar Ministria e Arsimit shkollimi në drejtimin e mjekësis kërkesa jonë ka qenë për 48 fëmi, por në pamundësi për afatin e parë na kanë lejuar gjysmën e asaj që ne kemi kërkuar për arsye që është kërkuar ndryshimi i statutit me miratim të kuvendit komunal. Është interes i përgjithshëm dhe duhet ta përkrahim këtë. Siq e tha dhe Mirëllinda numri i nxënësve në shkollën Qendra e Kompetencës është ngrit dhe është shfaq interesim i madhë për arsye të shtimit të disa drejtimeve të reja, siq është ngrit këtë vit dhe në shkollën “ Lasgush Poradeci” në Kijevë dhe do të ngritet dhe më shumë. Objekti fizik në shkollën Lasgush Poradeci në Kijevë nuk është aq e mirë por ne kemi pasur vizita nga përgjegjësit kryesor të Arsimit, e kanë parë objektin dhe ata e kanë vlersuar që mundet me u zhvillu një klasë me 24 nxënës në atë objekt sepse ju kemi ofruar dhe mundësin e kabinetit dhe që janë betuar që do ta paisin këtë shkollë dhe me kabinete që do ti shërbejë nxënësve në këtë drejtim të mjekësis. Pse është shpallur vetëm një vend, është shpallur një vend për një mjek të përgjithshëm është statuti që kërkohet aty mirë po kjo nënkupton faktin që aty kemi pasur dhe mësimdhënës të Biologjisë, të Kimisë, të Matematikës etj, të cilët nuk janë plotësuar normat dhe në këtë rast me 24 nxënës, do të ju plotësohet norma atyre mësimdhënësve që nuk e kanë pasur të plotësuar. Sa i përket Mjekut të përgjithshëm që do të fitojë mundësin që të jep mësim në këtë shkollë ai do të ket të përfunduar anatominë, praktikën dhe do të jenë dy infermier krejt këta do të jenë të inkuadruar në shërbime profesionale. Me investimin që do të ndodhë në atë shkollë të jeni të bindur që aty do të këni një interesim të madh nga nxënësit. Ju kisha lut që të bëhemi bashkë dhe ta mbështesim një projekt të tillë që është shumë i nevojshëm për atë drejtim në Komunën e Malishevës. Tek qështja se sa semimaturant janë regjistruar dhe sa është numri i nxënësve që regjistrohen për her të parë në bankat shkollore dhe në klas të parë i kemi të gjitha të dhënat për arsye se bashkëpunojmë me të gjithë Drejtorët e Shkollave dhe të gjitha do ti raportojmë kur do që të vjen koha që të raporton Drejtoria e Arsimit për punën që bënë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Alban!

**Alban Kastrati:** Ne si grup parlamentar i PDK-së u konsultuam dhe pasi që nuk kemi pasur material apstenojmë për këtë pikë të rendit të ditës.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Labinot!

**Labinot Gashi:** Unë e përmenda Qendrën e Kompetencës jo rastësisht fillimisht është thënë që Qendrat e Kompetencës kanë të drejtë studimi ka ndodhë e kundërta, pyetja ime është në këtë institucionin IAAP nxënësat a kanë drejtë studimi?

**Arbëresha Krasniqi:** Kërkesa që ne i kemi bërë Ministris së Arsimit është kthyer kjo përgjigje janë drejtorët e IAAP-ve dhe drejtorët e drejtorive komunale të arsimit, dhe këtu thotë: Bazuar në politikat qeveritare dhe nevojat e zhvillimit ekonomik të vendit MASHT-i në bashkëpunim me ekspertët e fushave përkatëse i ka hartuar korikulat e reja për arsimin dhe aftësimin profesional bazuar në standartet e nevojshme të cilëve i ka harmonizuar ato sipas librit për klasifikimin e profesioneve në Kosovë. Departamenti për arsim dhe aftësim profesional i ka lexuar profilet të cilat do të zbatohen në vitin shkollor prandaj kërkojmë nga DKA në Malishevë që t'i respektojë të gjitha marrëveshjet të cilat i kemi bërë në Ministrin e Arsimit, dhe njëkohësisht MASHT-i ka falenderuar institucionin e shkollës "Lasgush Poradeci", DKA-në për bashkëpunimin dhe kompletimin e kërkesës dhe si rezultat i kësaj ka ardhur deri tek vendimi që i lejohet shkollës së mesme "Lasgush Poradeci" që të ketë drejtime mjekësore dhe ato drejtime të tjera teknologjike që të ngritet avancimi dhe profilizimi i fëmijëve të cilët do të na evitojnë në këtë institucion.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit, Drejtoreshë!

E hedhim në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është për miratimin e kërkesës numër 11/1298 të datës 22.06.2022 të Drejtoris për Arsim dhe Edukim për miratimin e propozimit për ndryshimin e statutit shkolla e mesme profesionale Lasgush Poradeci në Kijevë në institucionin e arsimit dhe aftësimin profesional IAAP "Lasgush Poradeci" në Kijevë. Kush është për?

Për: 11

Kundër: 0

Abstenim: 6

Me 11- Për, 0-Kundër, 6-Abstenim, kalon kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e 3 e radhës është: Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Malishevës për vitin 2021. E hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës. Kush e dëshiron fjalën? Veton Zogaj e ka kërkuar fjalën!

**Veton Zogaj:** Faleminderit, Kryesues!

E para më vjen keq për këtë Raport të Auditimit dhe për këtë gjendje që paraqitet, nuk është ndonjëher që kemi dalur mirë në Raportin e Auditimit. Auditorin e ka nxjerrë Komuna e Malishevës me raport të kualifikuar. Komuna e Malishevës në këtë Raport në pasqyrat financiare është gjetur 3907E pasuri që është blerë, por që nuk ekzistojnë në librat financiar të Komunës. Arsyetimi i Drejtorit të Financave në KPF-ë ka qenë, sepse ka munguar zyrtari që e bënë këtë regjistrim në Databazë. Vlerësimi i pasurisë ishte 129146E regjistrimi i pasurisë së investimeve prapë nuk janë të regjistruara në databaz. Janë bërë 19 pagesa me vlerë prej 517,935E për faktura të projekteve që janë bartë mjetet në projekte, nga projekte të caktuara. Ky problem është duke e përcjellë Komunën e Malishevës për vite me radhë.

Në këtë

Raport Auditori thotë: gjatë trajtimit të detyrimeve të papaguara kemi vërejtur se 6 faktura në vlerë të 199,707E nuk ishin raportuar në raportet mujore të obligimeve të papaguara, po ashtu 7 faktura në vlerë prej 239,538E nuk ishin paguar brenda afatit 30 ditorë vonesat e këtyre pagesave kanë qenë nga 12 deri në 222 ditë. Përse nuk përfundojnë këto pagesa në afatin e duhur kohor. Me rastin e vlerësimeve të raporteve mujore për obligimet e pa paguara të raporteve ne kemi vërejtur se 6 Faktura me vlerë prej 199,707E nuk ishin të përfshira në raportin mujor obligativ. Po ashtu thesari sipas vendimeve gjyqësore përmbarimore kishte ekzekutuar pagesen nga buxheti i Komunës në vlerë 1,288474E problem i njëjt në vazhdimësi në Komunën e Malishevës. A keni ndonjë zgjidhje se si me dal nga kjo situatë? Po ashtu te subvencionet në Raport sipas buxhetit kanë qenë 400,000E, ndërsa në fund në raportet financiare nga kjo kategori janë shfrytëzuar 459,000E, 59,000E më shumë. Dhe në fund Komuna e Malishevës ka organizuar shetitje jashtë vendit për stafin, konkretisht në Shqipëri me kohëzgjatje prej 4 ditësh duke u paguar shpenzimet e transportit dhe akomodimit me shumën 4730E.

**Argjend Thaçi:** Fjalën e ka Valon Mazreku.

**Valon Mazreku:** Faleminderit, Kryesues!

Veton sa i përket Raportit normal që jemi të pajtimit që si opinion nuk është i mirë. Kemi qenë të hendikepum prej disa projekteve që dhurohen nga Ministrit dhe nga organizatat e tjera, mirëpo këta e kanë pasqyru një gjendje e cila ka qenë evidente në Komunën e Malishevës. Te pasuria çdo vit fiskal Komuna investon, dhe ato investime të cilat janë në shërbim të gjithë Komunitetit regjistrohën si pasuri Komunale. Pretekstin që e ka dhënë Drejtori i tashëm Blerim Thaçi që zyrtari nuk ka qenë në vendin e punës, është evident sepse ka pasur probleme shëndetësore dhe ne nuk kemi pasur mundësi me e plotësuar atë vend për shkak të kufizimeve që i kemi në raport me numrin fizik. Nuk kemi pasur njeri tjetër adekuat që mundet me e përfundu atë punë, pasi që në Drejtorinë e Financave secili Zyrtar që punon e ka qasjen e vetë dhe kufizimet e veta, mirëpo dhe kjo evidentohet nëse nuk është evidentuar vitin e kaluar evidentohet këtë vit. I njëjti problem është dhe te Epasuria, pra Komuna ka pasur kufizime nuk ka pasur mundësi me i plotësu pozitën e lira.

Sa i përket qështjes tjetër lëvizjet nga një projekt në projekt tjetër, është e vërtet që ka pasur lëvizje këto lëvizje janë të pasqyruara kryesisht tek rregullimi i rrugëve.

Tek qështja e subvencioneve, te subvencionet komuna i ka pasur 400,000E të buxhetuara por janë shpenzuar 459,000E , 59,000E kanë qenë me vendim të Qeverisë për shkak të vërshimeve që kanë ndodhur. Ndërsa sa i përket vendimeve të gjykatave kryesisht këto janë ardh si rezultat i kontratave kolektive, ky është një problem nacional problem shtetëror nuk është i Komunës tonë, të gjitha Komunat kanë probleme me vendimet gjyqësore dhe këto vendime gjyqësore pashmangshëm e kanë përcaktuar vonesën që mbas 30 dite është bërë pagesa e ati projekti.

**Argjend Thaçi:** Fjalën e ka Labinot Gashi!

**Labinot Gashi:** Është ndër Raportet më të këqia që unë kam pasur në dorë prej regjistrimit të pasurisë, Epasuria, vendimet gjyqësore etj. Mirëpo një që na lidh ne si kuvend e përmendi

përcaktimin i pagesave për projekte të caktuara nga buxheti i projekteve të tjera. Është mirë që projektet që votohen nga Asamblea Komunale, ato projekte me i vazhdu para. Kërkoj që propozimet që janë dhënë te regjistrimi i pasurisë, që disa janë zbatu dhe disa jo me i marr Komuna më seriozisht që lidhen direkt me ekzekutiv që na lidh ne si assembleis, t tjerat janë qështje të ekzekutivit.

**Argjend Thaçi:** Fjalën e ka Mirëlindë Gashi.

**Mirëlinda Gashi:** Gjatë leximit e pash që nuk është shumë mirë Raporti, ka të gjetura që janë dhënë disa vërejtje për raportet mujore, keni shkelur afatet kohore që janë të përcaktuara me ligj, e të tjera unë vetëm e përkrahi fjalimin e kolegëve të mi që i dhanë ato vërejtje shpresojmë që herave të tjera mos të gabojmë dhe të ecim përpara.

**Argjend Thaçi:** Fjalën e ka Halil Morina!

**Halil Morina:** Ne këtu po e debatojmë Raportin e Auditimit të vitit 2021, ajo që duhet të theksohet se natyra është e tillë sa të ka institucione publike ka me pasur nevojë me u përmisu ato institucione. Asnjëher nuk kemi me ardhë në atë pikën përfekte që Raporti i Auditimit ka me qenë pa asnjë vërejtje. Ajo që është e rëndësishme për Komunën e Malishevës është që përmirsimi me qenë progresivë, kjo do të thotë që nëse Raporti i Auditimit është pak më i mirë se ai i vitit të kaluar dhe ai që vjen në vitin e ardhshëm të jetë pak më i mirë se i këti viti kjo do të thotë që ne jemi në rrugën e duhur. Konkluzioni i përgjithshëm që e ka dhënë ky raport thotë: Pasqyrat financiare të komunës së Malishevës prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtet në të gjitha aspektet materiale. Ky është konkluzioni i përgjithshëm, ajo që është e mirë në këtë raport është fakti që rekomandimet që na ka dhënë auditori në raportin e auditimit të vitit të kaluar, pra i ka dhënë 9 rekomandime dhe 5 prej atyre ekzekutivi i Komunës i ka implementu. Këto rekomandime që na i ka dhënë këtë vit raporti i auditimit dhe këtë raport të auditimi duhet me e vlersu e mos me i pas të njejtat vërejtje dhe vitin e ardhshëm. Shumica e vërejtjeve lidhen me regjistrimin e pasurisë unë e inkurajoj ekzekutivin që me e zgjidh këtë problem. Problem tjetër është keqklasifikimi i buxhetit, dhe pagesa e një projekti me kalu në një projekt tjetër. Ky raport që i ka këto të gjetura ekzekutivi duhet me i marrë shumë seriozisht me i eliminu.

**Argjend Thaçi:** Fjalën e ka NënKryetari!

**Vesel Krasniqi:** Përshëndetje për të gjithë ju!

Raporti i Auditimit të jashtëm me të vërtet nuk na bënë me u ndi mirë, është një raport i kualifikum. Raport i kualifikum nënkupton që është bërë një shkelje dhe sa për informimin e juaj auditori gjeneral çdo vit vendos kritere deri ku mund të lejohen lëvizje. Për vitin 2021 e ka vendosur kriter regjistrimin e pasurisë, ka qenë më herët kriter lëvizja e projekteve, kontratat etj. Arsyeja që ne jemi zënë keq është që zyrtarja jonë ka qenë me probleme shëndetësore për 1 vit e gjysmë, është një llojë i arsyesimit për faktin që nuk kanë lëjuar me hapë konkurs për pozita të lira. Është hera e parë që nuk është gjetur asnjë e shkelur në procedur të prokuroris dhe nuk është gjetur në ekzekutiv të tyre. Zotohem para jush që së bashku me ju duke i marrur parasysh

vërejtjet e juaja do ti përmisojmë të gjitha të gjeturat. Raporti në përgjithësi është një raport prej më të mirëve mos të kish koinqidu regjistrimi i pasuris dhe në këtë kontekst mbi 50% e organizatave buxhetore ju kan kualifiku raportet, sepse të gjitha kanë probleme me regjistrimin e pasuris, tanimë e kemi marrur zyrtarin dhe do të rregullohen të gjitha. Tek keqëklasifikimi i projekteve u folë nga të gjithë, opozita e kaluar ka miratuar buxhet të mbingarkuar. Lab pajtohna me ty që disa projekte kanë mbetur në gjysmë por me fajiin e asambles sepse asamblea komunale nuk është konsultuar me ekzekutivin me mundësit buxhetore në këtë aspekt është pjes e fajit të opozitës. Do të kërkoj bashkëpunim me ju por jo ta kushtëzoj votën e juaj si asambleist për të futur X-projekte në pa mundësi buxhetore. Dera është e hapur për të gjithë ju tek Drejtori tek Kryetari të bashkëpunojmë për ato projekte që janë me rëndësi tek qytetarët dhe ta bëjmë një buxhet të mirë. Neve si organizata buxhetore në nivel lokal na takon deri në 5% të projekteve ta bëjmë ridestinimin e projekteve, dhe unë jam i sigurt që do ta shfrytëzojmë këtë mundësi duke filluar prej këti viti. Një e keqe më e madhe është nëse ai buxhet shkonë në suficid dhe të mbesin shumë projekte pa përfunduar. Kërkoj falje për diskutimin tim por deshta të i shpjegojë këto qështje e keqklasifikime që ndodhin në çdo komunë jo vetëm tek ne.

**Argjend Thaçi:** Fjalën e ka Drejtori për Buxhet dhe Financa!

**Blerim Thaçi:** Faleminderit, Kryesues!

Për herë të parë ka hyrë si kriter te auditori i jashtëm regjistrimi i pasuris dhe Epasuria, që jo vetëm për qështjen e mungesës së Zyrtarit por kanë qenë dhe disa vendime të Qeveris për zyrtarët e komunës, që përshkak të gjendjes shëndetësore me leje nga qeveria është në pushim mjekësor. Problemi është zgjidh dhe besoj që deri në janar të vitit 2023 te pasuria do të evidentohen në databaz. Tek qështja e keqklasifikimit e përmenden dhe NënKryetari dhe Valoni në raport është i paraqitur dhe shpenzimi që është ekzekutuar nga Thesari qendror për qështjet dhe vendimet gjyqësore për të cilën i kanë prishur dhe projektet e ndryshme dhe ato vonesa të pagesave janë bërë pikërisht për këtë arsye. Them që 2023 do të përmisohet i gjithë plani i pasuris.

**Argjend Thaçi:** Veton Zogaj, replikë/

**Veton Zogaj:** Prej 9 rekomandimeve të raportit të kaluar, 4 prej tyre janë të përsëritura, të paktën shpresojmë që prej 9 rekomandimeve të këti viti të realizohen të gjitha që të mos kemi të përsëritura prapë. Të paktën këto që i kemi vërejtje në raportin aktual të rregullohen dhe të mos kemi vrejttje të vazhdueshme për to.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Drejtor!

**Blerim Thaçi:** Faleminderit Veton dhe unë thash që ju premtoj që kriteri parë për kordifinim që është bërë për raportin do të realizohet në Janar të vitit 2023, dhe ju premtoj që do të përfundojnë dhe rekomandimet e tjera të cilat janë të evidentuar në raport.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit të gjithë për kontributin tuaj për këtë pikë të rendit të ditës që ka të bëjë me Raportin e Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Malishevës për vitin 2021.

Tani kalojmë në pikën e radhës shqyrtimi i kërkesës 08/176 data: 27/06/2022 të Drejtoris për Bujqësi pylltari dhe zhvillim rural për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit numër 02/211 datë: 05/05/2022 për themelimin e vend gjuetis në Komunën e Malishevës. Këtë pikë të rendit të ditës e kemi votuar por para disa seancave ministria ka kërkuar ndryshim tek ky vendim, nga Drejtoria për bujqësi nuk e kemi askënd që të na sqarojë në detaje. Material nuk kemi.

Veton Zogaj ka kërkuar fjalën pastaj Valon Mazreku.

**Veton Zogaj:** Nëse nuk ka sqarime kjo pikë duhet të shtyhet.

**Valon Mazreku:** Veton, ke të drejtë materiali është i mangët. Në mbledhjen kur është nxjerr ky vendim ka qenë kërkesë e Drejtoris së Bujqësisë me u përcaktu 10 hektar si vend gjuetie, mirëpo në atë kohë Drejtoria e Bujqësisë nuk janë konsultuar me pëlqimin që ja ka dhënë Ministria e Bujqësisë në vitin 2009 që në kuadër të këtij pëlqimi janë mbi 30 hektar vend gjuetie. Është kërkuar që të shfuqizohet ai vendim dhe kur të plotësohen dokumentet se në cilat zona ka me qenë vend gjuetie. Unë kërkoj që me u shfuqizu vendimi në mbledhjen tjetër kompletohet lënda dhe e marrim vendimin e ri.

**Argjend Thaçi:** Valon, në rend të ditës e kemi pikën e plotësim ndryshimit nuk mundemi që si pikë të veqant me e shti në rend të ditës.

Kush është që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e radhës?

Për: 18

Kundër: 0

Abstenim: 3

Shtyhet kjo pikë e rendit të ditës.

Pika radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës të komitetit për familje të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve të luftës së UÇK-së si dhe martirëve të luftës në Komunën e Malishevës.

Fjalën e ka anëtari i këtij komiteti z. Eqrem Morina.

**Eqrem Morina:** Në mbledhjen e 3 të mbajtur të këtij komiteti në bashkëpunim me shoqatën e dalur nga lufta hartoj planin e punës. Plani i veprimit është një platformë kryesore e komitetit për vlerat e luftës e cila përmbushet nga disa objektiva dhe rekomandime kryesor siq janë:

1. Hartimi dhe shqyrtimi i Draft-Planit të punës për vitin 2022.
2. Përcjellja e shqyrtimit i rregullt i punës dhe veprimeve komunale.
3. Përcjellja e punës së organeve komunale.
4. Adresimi i kërkesave dhe rekomandimeve.
5. Pjesmarrja në akademi përkujtimore dhe në organizime të festave kombëtare.
6. Krijimi i databazës në të gjitha datat historike të komunës së Malishevës.
7. Organizimi i konferencës vjetore.

8. Takimet me drejtorë të drejtorive.  
9. Përgaditja e Raportit të punës për vitin 2022 dhe plani i punës për vitin 2023.  
Kaq kisha Fakeminderit.

**Argjend Thaçi:** Fjzlën e ka kërkuar Labinot Gashi.

**Labinot Gashi:** Një shqetësim i imi është që ky plan vjetor i punës po na vjen në Gushtqë është me vones, por urojm që ky plan të cilin e kanë bërë të realizohet dhe ta ketë aprovimin tonë.

**Argjend Thaçi:** Kush është për Miratimin e planit të punës të komitetit për familje të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve të luftës së UQK-së si dhe martirëve të luftës në Komunën e Malishevës.

Me vota unanime, miratohet plani i punës së këtij komiteti.

Kalojmë me pikën e radhës që është:

Formimi i Komisionit Komunal të aksionarëve për ekoregjionin njësi në Malishevë, ky komision përbëhet prej tre antarëve, dy nga Kuvendi dhe një nga zyra e Kryetarit. Shkojmë me propozimet e kuvendit, urdhëro Halil!

**Halil Morina:** Është i domosdoshëm formimi i këtij Komisioni, dhe për këtë Komision ne propozojmë Valon Mazrekun.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Arlind!

**Arlind Morina:** Unë propozojë Hamit Limen.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit a ka propozime të tjera. Urdhëro Alban Kastrati!

**Alban Kastrati:** Ne e propozojmë Burim Paqarizin.

**Argjend Thaçi:** Kush është për që Valon Mazreku të jetë antarë i këtij komisioni?

Për: 18

Kundër: 0

Abstenim: 1

Kush është për që Hamit Lima të jetë anëtarë i këtij Komisioni?

Për: 13

Kundër: 2

Abstenim: 4

Kush është për që Burim Paqarizi të jetë anëtar i komisionit?

Për: 9

Kundër: 4

Abstenim: 6

Atëherë anëtarë të këti komisioni janë Valon Mazreku dhe Hamit Lima.  
Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës që është Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës 02/321 i datës: 07/07/2022 Të përshtruar nga z.Minire Helshani nga fshati Banjë për ndihmë financiare për shërim.

Valon Kasniqi ka kërkuar fjalën pastaj Valon Mazreku.

**Valon Krasniqi:** Vetëm deshta me pyet se këto kërkesa për ndihmë financiare a kanë ardhur nga komitetit për politik dhe financa dhe a janë përfshirë të gjitha kërkesat për arsye se nëse vinë këso kërkesa të na vinë në Kuvend të gjitha dhe jo vetëm disa.

**Argjend Thaçi:** Është Komisioni Valon që vendos dhe shumat që kanë të bëjnë me shifra të mëdha sjellen në Komitetin për politikë dhe financa. Valon Mazreku e ka fjalën.

**Valon Mazreku:** Këto pashmangshëm që janë diskutuar dhe në komitet dhe është thirr dhe debati dhe ka pasur kohë dhe mundësi me i bërë analizë. Ne e përkrahim këtë për arsye të vështirësive që i ka. Unë propozoj që një vlerë prej 2,000E të i ndahet zonjës.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Burim!

**Burim Paqarizi:** Besoj që këto raste që na vinë për ndihmë është mirë që me i trajtu dhe me shiku se qfar gjendje kanë. Sot na kan ardhur disa raste që me të vërtet kanë një gjendje jo të mirë, zonja në fjalë ka një sëmundje dhe ne jemi të gatshëm me e mbështet këtë rast. Unë e kisha bërë një propozim me shumë më të lartë në vlerë prej 3,000E.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Veton Zogaj

**Veton Zogaj:** Siç tha dhe Valoni dhe në Komitet i kemi shqyrtu dhe kemi bërë debate sa i përket këtyre kërkesave, çka kam kërkuar në komision po kërkoj dhe këtu që kërkesat të cilat vinë të sillen të gjitha në Kuvend dhe jo vetëm disa. Të na tregon Drejtori njëher se a ka financa që këto dy kërkesa të kenë shumën në vlerë 3,000E të dimë a kemi buxhet me i mbuluar këto shpenzime.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit Veton, fjalën e ka Labinot Gashi!

**Labinot Gashi:** Është mirë që kërkesa të tilla që vinë në KPF të shqyrtohen mirë dhe duhet të i shikojmë mundësit buxhetore që mos me na sjell probleme të tjera. KPF-ja për këtë arsye është që të konsultohen me drejtorin se deri në qfar shume mund të shkojnë ndihmat për këto kërkesa.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit, Labinot Gashi! fjalën e ka Halil Morina!

**Halil Morina:** Ne e dimë që një numër i madh i qytetarëve tonë kanë probleme shëndetësore fatëkëqësisht sëmundje të rënda, nganjëher sëmundjet munden me qenë të njëjta por kushtet financiare të familjeve nuk janë të ndryshme prej njëra tjetrës dhe ne kur e dimë që me të vërtet është gjendja e rëndë duhet me i ndihmu. Nëse janë kushtet buxhetore që me i ndihmu me shifren 3,000E atëherë ne jemi të gatshëm me i ndihmu.

**Blerim Thaçi:** Është një gjë që faktikisht buxheti është i limituar, mirëpo mbi bazen e shpenzimeve që kanë ndodh deri në muajin korrik në kategorin e subvencioneve është rreth 46% që pjesa më e madhe e subvencioneve është shfrytëzuar tek zyra e Kryetarit, më pak te Shëndetësia, dhe te Drejtoria e Bujqësis. Për këto kërkesa këto shuma janë të mbulueshme por të shqyrtoni dhe të mendoni se mund të rritet numri i kërkesave për ndihmë. Këto kërkesa që janë sot, Drejtoria e Financave do të i mbulojë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Veton Zogaj!

**Veton Zogaj:** Drejtori po tregon që mundet me i mbulu shumën për këto kërkesa që janë sjellur sot por nuk cekti shumë, cila është shuma?

**Blerim Thaçi:** Në bazë të buxhetit ne mundemi me i ndihmu deri në 15-20,000E këto tri kërkesa.

**Argjend Thaçi:** Në konsultim me Drejtorin dhe shefat e grupeve janë tri rastet pothuajse të njëjta propozuam që shumat të jenë të njëjta. Shuma të jetë nga 5,000E për secilin rast. Kush është për miratimin e kërkesës 02/321 datës: 07/07/2022 të parashtruar nga z.Minire Helshani nga fshati Banjë për ndihmë financiare për shërim në shumën prej 5,000E. Kush është për? Me vota unanime miratohet kjo kërkesë.

Pika tjetër e rendit të ditës është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës numër 02/341 data: 27/07/2022 të parashtruar nga Z.Pajtim Krasniqi nga fshati Tërpezë për ndihmë financiare për shërim në shumën prej 5,000E. Kush është për? Me vota unanime, miratohet kjo kërkesë.

Pika tjetër është: Ndhimja financiare për fëmijet e aksidentuar të familjes Sopaj, kush është që këtyre fëmijëve të ju ndahet shuma prej 5,000E? Me vota unanime, miratohet dhe kjo kërkesë.

Kalojmë tek pika e radhës së rendit të ditës: Zëvendësimi i anëtarit të Komisionit të aksionarëve të stacionit të autobusëve, tërhiqet Hafir Rexha dhe në vend të tij propozohet Donjeta Stolliqi. Kush është për?

Për: 13

Kundër: 0

Abstenim: 8

Miratohet zëvendësimi i anëtarit të komisionit

Pika e fundit tek të ndryshmet është: Caktimi i lokacionit për varrezat e fshatit Bellanic.

Materialin e kanë shefat e grupeve.

Fjalën e ka Astrit Sertolli!

**Astrit Sertolli:** Po besoj e keni lexuar dhe e keni përpara kërkesën e kryesis së fshatit Bellanic, dihet që bellanica e ka ru gjithmonë pronën publike, por tek varrezat që janë është plotësu numri

dhe kërkojmë një lokacion të ri. Janë disa njesi kadastrale dhe kërkes e jona është që të i bëjmë bashk këto njesi dhe me e pas më të lehtë caktimin e lokacionit.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit, Astrit!

Kush është për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Bellanicë sipas kërkesës 02/190. Kush është për?

Me vota unanime, miratohet kjo kërkes.

Nëse nuk keni diqka për të shtuar këtë mbledhje e shpalli të mbyllur.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Kryesuesi i Kuvendit  
Argjend Thaçi

